

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-267/13

**Prishtinë,  
2 dhjetor 2015**

Në çështjen juridike të:

**Q. E.**

Jabllanicë e Vogël

Komuna e Pejës

**Pala ankuese**

kundër.

**R. L.**

**Pala përgjegjëse në ankesë/Paraqitësi i kërkesës**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Anna Bednarek, në Ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/140/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA07767, KPA07770, KPA07773, KPA07774, KPA07775 dhe KPA07776), të datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 2 dhjetor 2015, mori këtë:

## JUDGMENT

1. Lëndët GSK-KPA-A-267/13, GSK-KPA-A-268/13, GSK-KPA-A-269/13, GSK-KPA-A-270/13, GSK-KPA-A-271/13 dhe GSK-KPA-A-272/13, janë bashkuar në një lëndë të vetme nën numrin GSK-KPA-A-267/13.
2. Hedhet si e vonuar ankesa e Q. E. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/140/2012 datë 29 shkurt 2012, për sa i takon lëndëve të regjistruara në AKP nën numrat KPA07767, KPA07770, KPA07773, KPA07774, KPA07775 and KPA07777.

### Përmbledhja e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Më 3 janar 2007, R. L. (në tekstin e mëtejme: Pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së pronësisë, ri-posedimin dhe kompenzimin për pronat.

Të dhënat rreth ngastrave të kërkuara janë si në vijim:

Numri i ankesës	Numri i dosjes së AKP-ës	Të dhënat e ngastrave
GSK-KPA-A-267/13	KPA07767	Ngastra numër 417/2, që gjendet Pejë, zona kadastrale e Jabllanicës së Vogël, kullosë e klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 0ha 06ar 65 m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-268/13	KPA07770	Ngastra numër 426/1, që gjendet Pejë, zona kadastrale e Jabllanicës së Vogël, livadh i klasës së 2-të, me sipërfaqe prej 0 ha 32ar 16m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-269/13	KPA07773	Ngastra numër 426/2, që gjendet Pejë, zona kadastrale e Jabllanicës së Vogël, livadh i klasës së 2-të, me sipërfaqe prej 0 ha 7ar 24m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-270/13	KPA07774	Ngastra numër 109, që gjendet Pejë, zona kadastrale e Jabllanicës së Vogël, malë klasa

		e 4-të, me sipërfaqe prej 0ha 81ar 63m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-271/13	KPA07775	Ngastra numër 426/3, që gjendet Pejë, zona kadastrale e Jabllanicës së Vogël, pemishte klasa e 4-të, me sipërfaqe prej 0ha 17ar 70m <sup>2</sup> ;
GSK-KPA-A-272/13	KPA07776	Ngastra numër 426/3, që gjendet Pejë, zona kadastrale e Jabllanicës së Vogël, pemishte klasa e 4-të, me sipërfaqe prej 0ha 24ar 33m <sup>2</sup> ;

Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se ka humbur posedimin e pronës së kërkuar me 16 qershor 1999 si rezultat i rrethanave në vitin 1998/1999.

2. Për të mbështetur Kërkesën e tij, Pala përgjegjëse ka paraqitur këto dokumente:
  - Transkriptin/Ekstraktin nga Fleta Poseduese (FP) Nr. 37, e lëshuar nga Qendra për Kadastër e Pronës së Paluajtshme e Komunës së Pejës me datë 25 maj 2004;
  - Leternjoftimin Nr. 20019529300113, i lëshuar me 9 qershor 2004; dhe
  - Çertifikata e Vdekjes No. 203-13/289/06-III-07, e lëshuar nga Komuna e Pejës me datë 13 December 2006.
3. Njësia e Verifikimit të AKP-ës në raportet e saja të datave 6 shkurt, 7 maj, 18 korrik, 15 tetor, 8 dhe 21 nëntor të vitit 2007, si dhe Raportete të Konsoliduara të Verifikimit të datave 13, 19, 21, 22, 23 nëntor dhe 5 dhjetor 2007, Fleta Poseduese Nr. 37 dhe Certifikata e Vdekjes Nr. 203-13/289/06-III-07, janë verifikuar pozitivisht në Departamentin për Kadastër të Komunës së Pejës, respektivisht në Administratën e Komunës së Kragujevcit, Republika e Serbisë.
4. Me datë 7 shkurt 2007, AKP-ja ka bërë njoftimin për Kërkesë përmes një shenje të vendosur në pronën e gabuar. Gjatë vizitës së bërë nga ana e Ekspertit Njoftues të AKP-ës pronës ishte konstatuar se prona nuk ishte e zënë.
5. Me datën 19 shkurt 2007, bazuar në njoftimin e gabuar të bërë, KKPK-ja kishte nxjerrë Vendimin e saj KPCC/D/A/5/2007 në të cilin është thënë se Pala përgjegjëse në ankesë kishte deshmuar se babai i tij V. L. ishte pronar i pronës së kërkuar.
6. Ishte vërtetuar se njoftimi për Kërkesën nuk ishte bërë në mënyrën e saktë. Me Vendimin e KKPK-ës të datës 24 shkurt 2010, Nr. KPCC/RES/16/2010, vendimi i mëhershëm (KPCC/D/A/5/2007) ishte anuluar dhe kërkesa ishte kthyer në Sekretarinë Ekzekutive për procedim të mëtejshëm për identifikimin e saktë të kërkesës dhe njoftimit të duhur të

kërkesës në pronën e kërkuar dhe dëgjimin e cilësdo palë përgjegjëse në lidhje me Kërkesën.

7. Njoftimi i saktë përmes publikimit në Gazetën Zyrtare e AKP-së dhe Buletinin e Zyrës së Pronës të UNMIK-ut është bërë me 30 Gusht 2010. Gazeta e AKP-ës dhe Buletini i ishte lënë kryetarit të fshatit në mëyrë që ai ta bënte të arritshëm atë për palët e interesuara, pataj në një shitore të vogël në hyrje fshatit dhe këndin e rrugës publike në dalje të fshatit Jabllanicë, Komuna e Pejës. Për më tepër i njefti publikim (Lista dhe Gazeta) është publikuar në Komunën e Pejës-Zyra e Avokati Publik, Zyrën Kadastrale, Gjykatën Komunale, Zyren Regjionale të Agjencionit Kosovar të Pronës, Kryqin e Kuq Danez (KKD), OSBE, UNHCR, Ombusperson, Agjencioni Kosovar të Privatizimit dhe EULEX.
8. Sidoqëtjetë me njoftimin (i saktë) të sipërcekur lidhur me kërkesën, nuk është dorëzuar asnjë njoftim për pjesëmarrje.
9. Me Vendimin e tij KPCC/D/A/140/2012, të datës 29 shkurt 2012, KKPK-ja ka vendosur që Pala përgjegjëse në karkesë ka dëshmuar se V. L. ishte pronar i pronës së kërkuar, se ai ka të drejtë në posedimin e kësaj prone, dhe se çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën duhet ta lirojë atë mbrenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të urdhërit.
10. Vendimi i KKPK-ës është pranuar nga Pala përgjegjëse në ankesë me datë 23 korrik 2012. Q. E. (në tekstin e mëtejme: Pala ankuese) ka pranuar vendimin e KKPK-ës me datë 22 mars 2013.
11. Pala ankuese ka ushtruar 6 Ankesa më datë 23 prill 2013. Pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar Ankesat e ushtruara me datë 26 shkurt 2014. Sidoqoftë ajo nuk ka paraqitur Përgjigje në Ankesë.
12. Me 29 korrik 2015, B. L., djali i Pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar një Urdhër nga Kolegji i Apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës i Gjykatës Supreme të Kosovës. Megjithatë, Pala përgjegjëse në ankesë (ose djali i tij) nuk janë përgjigjur kërkesave nga Urdhëri i cekur, përveq që është dorëzuar kopja e Çertifikatës së lindjes dhe Leternjoftimit të B. L..
13. Me 6 tetor 2015, Pala ankuese ka pranuar një Urdhër nga Kolegji i Apelit të Agjencionit Kosovar të Pronës i Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa që ai në këtë urdhër ka paraqitur përgjegjen e tij me datë 8 tetor 2015.

**Arsyetimi ligjor:**

*Pranueshmëria e ankesave*

14. Ankesat janë të papranueshme sepse janë paraqitur jashtë afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi Zgjidhjen e Kërkesave që ndërlidhen me Pronën e Paluajtshme Private, Përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/50) i cili përcakton se: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”.*
15. KKPK-ja ka vendosur për këtë lëndë me vendimin e vet KPCC/D/A/140/2012 të datës 29 shkurt 2013. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 22 mars 2013. Afati ligjot për paraqitjen e ankesës ishte 22 prill 2013, dhe ankesat janë paraqitur me datë 23 prill 2013 (një ditë më pas).
16. Gjykata Supreme nuk ka mundur të gjejë ndonjë arsye se pse Pala ankuese duhet të arsyetohet për këtë vonesë. Pala ankuese ishte paralajmëruar mjaftueshëm rreth afatit dhe nuk ka dhënë asnjë arsye të pranueshme për vonesë.
17. Në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 13.3.(b) të Ligjit 03/L-079 dhe nenin 195 (a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Gjykata Supreme vendosi të hedhë Ankesat si të vonuara, si në dispozitivivin.

**Këshillë ligjore:**

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, ky Aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Gjyqtari Kryesues**

**Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtari i EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**